

VENDIM
Nr. 628, datë 7.9.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SHËTITORJA QEPARO LOTI 2” DHE “SHËTITORJA QEPARO LOTI 1”, HIMARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shëtitörja Qeparo loti 2” dhe “Shëtitörja Qeparo loti 1”, Himarë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtësë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 4 699 660 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 699 660 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "SHETITORE QEPARO LOTI 1"

SHUMA=	156509.75
--------	-----------

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "SHËTITORE QEPARO LOTI 2"

[illegible]

14	Fero		Theodor	Udhise	11/0/84	3099	898.37 m²			204 loka/m²		183267.48	X	Qeparo fashë
15	Qesari		Niko	Udhise	11/0/83	3099	986.83 m²			204 loka/m²		118489.33	X	Qeparo fashë
16	Erashë		Vasil	Udhise	11/0/82	3099	326.38 m²			204 loka/m²		46144.8	X	Qeparo fashë
17	Hygo	Zaho	Polo	Udhise	11/0/88	3099	1,312.38 m²			204 loka/m²		247305.12	X	Qeparo fashë
18	Shtet			Trial	11/0/87	3099								Qeparo fashë
19	Qusa	Disashir	Leonida	Udhise	11/0/90	3099	487.91 m²			204 loka/m²		91411.68	X	Qeparo fashë
20	Shtet			Udhise	11/0/91	3099								Qeparo fashë
21	Kokodhane		Arlenda	Ari	11/03/1	3099	2647 m²			204 loka/m²		539988	X	Qeparo fashë
22	Shtet			Trial	11/1/6	3099								Qeparo fashë
23	Shtet			Trial	11/1/1	3099								Qeparo fashë
24	Shtet			Trial	121/9	3099								Qeparo fashë
25	Shtet			Trial	123/11	3099								Qeparo fashë
26	Shtet			Trial	128/87	3099								Qeparo fashë
27	Shtet			Trial										Qeparo fashë

Shuma: 4,543,150.24